



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
DREJTORIA E STUDIMEVE

Nr. 1038 Prot.

Tiranë, me 22. 04. 2003

LËNDA: Për sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale

PROKURORIVE
PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS
SË PARË

PROKURORIVE PRANË
GJYKATAVE TË APELIT

GJITHË DREJTORIVE

KËTU

Ne inspektimet dhe kontrollet e ushtruara në disa Prokurori pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore janë evidentuar raste të praktikave të gabuara dhe joligjore në sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale, siç janë:

- policia gjyqësore, në rastet e verifikimeve të ngutshme, kur sekuestron provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale:
 - nuk dorëzon kopje të aktit personit që i sekuestrohen sendet, si dhe;
 - nuk respekton afatin 48 orë për dorëzimin në prokurori të procesverbalit të sekuestrimit.
- kur policia gjyqësore dërgon në afat procesverbalin e sekuestrimit, të kryer në kushtet e verifikimeve të ngutshme në vend, ka raste që prokurorët nuk respektojnë afatin 48 orë për vleftësimin e sekuestrosh me vendim të motivuar të provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale.
- ka raste, gjithashtu, që prokurorët nuk vendosin sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale, të marra pas këqyrjes së vendit të ngjarjes apo kontrollit të banesës, lokalit ose personit, etj.

Ju sjellim në kujtesë se sekuestrimi është një nga mjetet e rëndësishme të kërkimit të provës, me anë të të cilit realizohet kufizimi i përkohshëm - deri në një vendim përfundimtar të prokurorit ose gjykatës

- i të drejtave pasurore të një personi mbi një send të caktuar, objekt konkret i luajtshëm, i paluajtshëm apo shumë të hollash, nëpërmjet marrjes së sendit apo shumës së të hollave, ose nëpërmjet detyrimit për të mos i ushtruar të drejtat kur sendi nuk mund të merret apo nëpërmjet detyrimit të të tretëve të mos i japin mundësi personit të gëzojë sendin ajo të hollat. Ligjshmëria në kryerjen e sekuestrimit është e lidhur ngushtë me respektimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për kryerjen e tij.

Në ushtrimin e funksioneve për kryerjen e sekuestrimit, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore duhet të kuptojnë dhe konceptojnë drejtë objektin e sekuestrimit, i cili është i lidhur ngushtë me kuptimin e provës materiale, neni 187 i K. Pr. Penale dhe sendeve që lidhen me veprën penale. Kështu, objekt i sekuestrimit janë:

- **sendet që kanë sherbyer si mjet për realizimin e veprës penale**, siç mund të jenë: një armë; një dozë/sasi helmi; mjete motorrik tokësor apo detar që ka transportuar klandestin, drogë, mallra kundrabandë, etj;
- **sendet mbi të cilat gjenden gjurmët e veprës penale, siç mund të jenë:** veshjet e viktimës ose automjeti mbi të cilat gjenden njolla gjaku, faktor të qitjes dhe dëmtimit me armë zjarri; objekte/sende ku gjenden gjurmë daktiloskopike, etj;
- **sendet që kanë qenë objekt i veprimtarive të të pandehurit, siç**
- mund të jenë: sendet e vjedhura, etj;
- **sendet që përbëjnë objektin e përftimit nga vepra penale, siç** mund të jenë: të ardhurat apo objektet e siguruar nga veprimtaria kriminale, traikimi njerëzor, i drogës, shfrytëzimi i prostitucionit, shitja e sendeve të vjedhura, etj; përfitimet që realizohen nga shmangia e detyrimeve fiskale, etj, si dhe;
- **sende që lidhen me veprën penale, siç mund të jenë ato sende që** ndihmojnë në sqarimin e rrethanave të çështjes dhe për individualizimin e fajtorit, si pasaporta ose fotografi të autorit/bashkautorëve të veprës penale, etj.

Theksojmë se sekuestrimi mund të kryhet në rrethana që kërkojnë:

- **procedurë të ngutshme**, mbështetur në nenet 300/2, 301 e 303/ç të K. Pr. Penale, ose;
- **procedurë normale**, mbështetur në nenet 208 - 220, 309, 310 e 315 të K. Pr. Penale.

1. Procedura e ngutshme, në sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale është disponim në kompetencë të

oficerëve të policisë gjyqësore, që kryhet me iniciativën e tyre, në kushtet kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, neni 300 pika 2 e K. Pr. Penale.

Oficerët e policisë gjyqësore, kur ndodhen në këto kushte, duhet:

- të vënë sekuestron mbi sendin objekt sekuestrimi;
- të mbajnë procesverbal për veprimet që kryejnë, duke përshkruar, emërtimin, pamjen, madhësinë, ngjyrën, peshën ose karakteristika të tjera të sendit, si dhe duke shënuar shkaku pse u krye sekuestrimi mbi sendin, si dhe;
- të sigurojnë vulosjen dhe ruajtjen e tij.

Në kryerjen e sekuestrimit, ato duhet të lejojnë praninë e mbrojtësit të të pandehurit që ka marrë dënimin se po bëhet sekuestrimi, kur ka të tillë.

Oficerët e policisë gjyqësore, gjithashtu, duhet:

- ti dorëzojë një kopje të procesverbalit personit të cilit i janë sekuestruar sendet, si dhe;
- brenda 48 orëve procesverbalin t'ia dërgojnë prokurorit kompetent.

Prokurorët, në këto raste, duhet të jenë të vëmendshëm që:

- brenda 48 orëve, të shqyrtojnë dokumentacionin e ardhur nga oficeri i policisë gjyqësore;
- me vendim të arsyetuar të vleftësojnë sekuestron ose të vendosin kthimin e sendeve të sekuestruara, duke njoftuar për vendimin e marrë personin të cilit i janë sekuestruar sendet, neni 301 pika 2 e K. Pr. Penale, si dhe;
- të depozitojnë në sekretari praktikën e këtij veprimi hetimorë, për të qenë në dispozicion të mbrojtësit, neni 309 pika 2 e K. Pr. Penale.

Në kujtesën, e oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve, për rastet në procedurë normale, duhet të fokusohet se kryerja e veprimit hetimorë jashtë kushteve të lartpërmendura mund të sjellë pavlefshmëri relative të sekuestrimit. Ndërsa, moslejimi i mbrojtësit të të pandehurit për të marrë pjesë në kryerjen e këtij veprimi mund të sjellë pavlefshmëri absolute.

2. Procedura normale, në sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale është disponim në kompetencë të prokurorit ose gjyqtarit, në kushtet kur sekuestrimi i tyre është i domosdoshëm për të vërtetuar faktet që lidhen me veprën penale, neni 208 pika 1 e K. Pr. Penale.

Prokurorët, kur ndodhen në këto kushte, në rastet që nevoja për sekuestro lind gjatë veprimeve hetimore paraprahe të oficerit të policisë gjyqësore, duhet:

- ♦ të shqyrtojnë kërkesën e tij dhe të vendosin për sekuestrimin e provës materiale apo sendeve që lidhen me veprën penale, duke identifikuar në vendim edhe: sendin që duhet ti nënshtrohet sekuestrimit, personin pranë të cilit ndodhet sendi, si dhe oficerin e policisë gjyqësore që do ti delegohet ky veprim (në rast se nuk do ta kryejë vetë prokurori);
- ♦ të njoftojë për sekuestrimin personin e pandehur, kur ka të tillë, që të jetë i pranishëm së bashku me mbrojtësin ose të caktoj një mbrojtës kryesisht nëse i pandehuri nuk ka mbrojtës, neni 310/1 i K. Pr. Penale;
- ♦ brenda tre ditëve deponon në sekretarinë e prokurorisë procesverbalin, në rastet kur sekuestrimi është bërë ndërkohë që ka një person të pandehur, duke i dhënë mundësi avokatit të studioj dhe të nxjerr kopje të akteve, neni 309 pika 3 e K. Pr. Penale.

Mos ushtrimi i të drejtës nga ana e të pandehurit apo mbrojtësit të tij pa shkak nuk pengon kryerjen e sekuestrimit, sepse në këtë rast prokurori cakton një mbrojtës kryesish, neni 310/2 i K. Pr. Penale.

Në procedurën normale, kur nevoja për sekuestrimin e provave dhe sendeve që lidhen me veprën penale lind si rezultat i veprimtarisë së **oficerëve të policisë gjyqësore**, ata duhet:

- t'i paraqesin prokurorit kërkesën për sekuestrim ku të përshkruhet sendi që do të sekuestrohet, vendndodhja e tij, personi që e disponon sendin, persona të tjerë që kanë tagra të ndryshme pasurore mbi të, lidhja që ekziston midis sendit dhe veprës penale që hetohet, fakti që është i nevojshme të provohet nëpërmjet sekuestrimit të sendit etj;
- t'i dorëzojnë kopjen e vendimit të prokurorit për sekuestrim personit të interesuar ku do të kryhet sekuestrimi, nëse ky është i pranishëm;
- të realizojnë sekuestrimin, i cili bëhet në mënyra të ndryshme, në varësi të natyrës së sendit, siç janë:
 - duke e marrë fizikisht provën materiale apo sendin që lidhet me veprën penale dhe duke e ruajtur atë në sekretarinë e prokurorisë pasi të jetë mbyllur e vulosur me vulën e tij, nenet 214 e 215 të K. Pr. Penale;
 - duke marrë masa për ruajtjen e tyre në një vend tjetër dhe duke përcaktuar mënyrën e ruajtjes së tyre, për sende të luajtshme që nuk mund të ruhen në sekretari, si dhe duke përcaktuar në procesverbalin për lënien në ruajtje të sendit edhe përgjegjësinë që

- ka personi për sendin, si dhe detyrimin për t'ia dhënë organit procedues, sendin në ruajtje, sa here që i kërkohet etj;
- duke mbyllur e vulosur rrugët e hyrjes në të dhe duke vënë shenja dalluese se ky objekt është në dispozicion të drejtësisë, për sendet e paluajtshme siç mund të jenë një banesë apo një lokal, etj;
 - të bëjnë riprodhime të sendeve që mund të ndryshojnë me kalimin e kohës apo për ndonjë faktor tjetër, si dhe me miratimin e prokurorit, të bëjnë tjetërsimin apo asgjësimin e sendit, nëse prokurori nuk do ta kryej vetë këtë veprim;
 - të mbajnë procesverbal sa herë që do të hiqen vulat për të kryer ndonjë veprim hetimorë me sendin dhe nëse konstaton ndryshime mbi sendin, si dhe të rivulosin atë pas kryerjes së veprimit, duke vendosur datën e veprimit pranë vulës, neni 216 i K. Pr. Penale.


Në kujtesën, e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, duhet të fokusohen rastet kur sekuestrimi në procedurë normale mund të bëhet i pavlefshëm: - kur nuk njoftohet i pandehuri ose mbrojtësi i tij; - kur prokurori nuk ka caktuar kryesisht mbrojtës për të pandehurin që nuk ka të tillë ose kur ato nuk janë paraqitur për kryerjen e veprimit.

3. Prokurorët, gjithashtu, **ne fokusin e sekuestrimeve duhet të kuptojnë dhe zbatojnë drejt edhe dispozitat ligjore** të seksioneve që lidhen me të, siç janë "**Provat Materiale**", "**Këqyrjet**", "**Kontrollet**", etj. që ndonëse janë në krerë të ndryshme të K. Pr. Penale, nuk mund të kuptohen dhe funksionojnë të pa harmonizuara/ndërthurura ndërmjet tyre. Kështu:

- ◆ Në rastet kur gjatë hetimeve paraprake, rezulton se një send/provë materiale ka lidhje me veprën penale që hetohet, domosdoshmërisht procedohet me mbajtjen e një procesverbali për marrjen e provës materiale, neni 188 i K. Pr. Penale. Kështu procedohet edhe gjatë veprimeve të tjera hetimore paraprake, si këqyrje, kontrole, etj. por theksojmë se:
 - marrja e provës materiale me procesverbal nuk përjashton marrjen e një vendimi për sekuestrimin e saj, gjithashtu;
 - vendimi i sekuestros mbi një send/provë materiale nuk përjashton marrjen e saj me procesverbal, ku të bëhet përshkrimi i hollësishëm i saj dhe të fiksohet edhe me fotografi ose filmim.
- ◆ Në rastet kur merr pjesë vetë prokurori për marrjen e provës materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale, si në këqyrje, kontrole e veprime të tjera hetimore, ai vendos me vendim të arsyetuar sekuestrimin e tyre, duke respektuar procedurën e lartpërmendur dhe duke i dorëzuar të interesuarit kopjen e vendimit, për t'i garantuar atij të drejtën e ankimit në gjykatë. Por vlen të theksohet se ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit, nenet 208, 212 e vijues të K. Pr. Penale.

Kjo qarkore të punohet me të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve. Drejtuesit e prokurorive, të marrin masat e duhura organizative dhe ligjore, për të kontrolluar prokurorët dhe bashkë me drejtuesit e seksioneve dhe të shërbimeve të policisë gjyqësore, të ndihmojnë dhe mbikëqyrin oficerët e policisë gjyqësore, në kryerjen e sekuestrimit të provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale me synim që shkeljet e evidentuara të lidhura me ushtrimin e funksioneve ligjore të prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore, të mos përsëriten në të ardhmen.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM


THEODHORI SOLLAKU